



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR

Nr. 1849/1 Prot.

Tiranë, më 26.03. 2025

Lënda: Përcillet urdhri/vendimi i përbashkët për miratimin e tekstit mësimor për diasporën  
Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli III

QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Rruga “Vilat Gjermane”, Vila nr.6

Tiranë


Bashkëlidhur, po ju dërgojmë Urdhrin/Vendimin e përbashkët për miratimin e tekstit mësimor për diasporën “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” niveli III, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë me nr. 1849 prot., datë 17.03.2025 dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës me nr. 01/1010 prot., datë 18.03.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo - Republika Kosova  
Qeveria - Government - Vlada

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit /  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation /  
Ministritvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija

Nr. 1849 Prot.

Datë 17.03 2025

Nr. 01/1010 Prot.

Datë 18-03 -2025

## URDHËR/VENDIM I PËRBASHKËT

### PËR MIRATIMIN E TEKSTIT MËSIMOR PËR DIASPORËN “GJUHA SHQIPE DHE KULTURA SHQIPTARE”, NIVELI III

Me propozim të Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë për Miratimin e Teksteve të Mësimore për Diasporën, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 23.03.2015, “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, dhe bazuar në Vendimin nr. 756, datë 23.9.2020, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”,

### URDHËROJME/ VENDOSIM:

1. Miratimin e tekstit mësimor për diasporën “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” niveli III, i shtëpisë botuese “Albas” dhe shtëpisë botuese “Dukagjini”, i renditur i pari në listën fituese të konkursit për tekstin mësimor për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë.


2. Shtëpia botuese “Albas” dhe shtëpia botuese “Dukagjini” të përmbushin detyrimet e botimit për tekstin mësimor për diasporën “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli III, të kërkuara nga ministritë përgjegjëse të arsimit të të dy vendeve.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, Komisioni i Përbashkët Shqipëri - Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër/vendim i përbashkët hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**OGERTA MANASTIRLIU**



**MINISTRI I ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**  
**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**ARBËRIE NAGAVCI**

